



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

**VENDIM**

**Nr. 112, datë 07.08.2019**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË VLERËSIMIT, PIKËZIMIT DHE  
RENDITJES SË KANDIDATËVE TË LEJUAR PËR DISA VENDE VAKANTE NË  
GJYKATËN KUSHTETUESE**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 229, 239 dhe 240 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar për vendet vakante, si më poshtë:

- a) Vendi vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018.
- b) Vendi vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi, në datën 12.02.2018.
- c) Vendi vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 04.03.2019.
- ç) Vendi vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi, në datën 04.03.2019.

2. Diskutimi dhe vendimmarrja e Këshillit për fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar për vendet e tjera vakante në proces, do të merret në mbledhjen e radhës së Këshillit, të datës 09.08.2019.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

**KRYETARI**

**Ardian Dvorani**

